

KONCERTI

Uvertura e operës "Don Giovanni" të Mozart-it i dha tonin të gjithë koncertit, duke zbuluar një tingëllim sa të unifikuar e të butë të orkestrës, aq edhe sugjestiv falë akordeve gjëmuese e dramatike të kësaj uverture...

Orkestër e vlerave të mëdha të një vendi të vogël

Mbi koncertin e Orkestrës Simfonike Kombëtare të Malit të Zi

Eno Koço *


Më 22 mars 2016 Orkestra Simfonike Kombëtare e Malit të Zi dha në Teatrin e Operës dhe Baletit në Tiranë koncertin e saj të parë në Shqipëri. Shkoja të dëgjoja një orkestër të një vendi të vogël ballkanik dhe u ndodha përpara një orkestre europiane. Sa befasi aq dhe kënaqësi e papërshkrueshme. Disiplinë nga fillimi në fund, që nga paraqitja formale aq e hijshme e muzikantëve në skenë, deri tek disiplina e mirëfilltë e parametrave teknikë muzikorë.

Programi ishte i natyrës klasike orkestrale, me një uverturë, një pjesë kombëtare malazeze dhe një koncert për dy solistë e orkestër në pjesën e parë të programit, për të pasuar me një simfoni në pjesën e dytë.

Uvertura e operës "Don Giovanni" të Mozart-it i dha tonin të gjithë koncertit duke zbuluar një tingëllim sa të unifikuar e të butë të orkestrës, aq edhe sugjestiv falë akordeve gjëmuese e dramatike të kësaj uverture. Introduksioni i ngadalshëm i veprës emetonte një fuzion të admirueshëm orkestral, veçanërisht të harqeve, për t'ia lënë vendin stilit brilant e të shkathët mozartian, elementë këta kontraktues në funksion të dramaturgjisë muzikore së operës në tërësi. Dirigjenti Grigorij Krasko diti të nxjerrë më të mirën e mundshme të tingëllimit të kësaj orkestre kryesisht me të rinj. Frymëmarrjet midis frimeve arkitektonikë të uverturës ishin të përllogaritura me një aftësi edhe pse ndonjë herë pak sa bujare.

Kompozitorja Nina Perović solli në këtë koncert pjesën e saj "Gusla". Miku im që kisha në krahë më tha që soloja e violonçelit tingëlton krejt si lahuta e jonë. Në fakt, gusla e lahuta janë një në Ballkan, që si malazezët ashtu dhe shqiptarët e trajtojnë sipas traditës së tyre shekullore në interpretim, pra me fjalët e secilës gjuhë dhe ngjyrimet përkatëse, por që ky folklor i trevave malore do të mbarë të mjaft elementë të përbashkët. Pjesa ishte shkruar me shije të hollë dhe ndjehej në të forca shpirtërore dhe intelektuale e ardhmërisë së kompozitores.

Koncerti për flaut, violinë dhe orkestër i kompozitorit neo-klasik çek Bohuslav Martinů, u përçua nën interpretimin e flautistes Marija Durdević dhe violinistit Marko Radonić. Muzika elegante dhe inteligjente e këtij kompozitori u përlligj më së miri nga bashkëveprimi i të tre kompo-



Në foto:
Orkestra
Simfonike
Kombëtare e
Malit të Zi

Në foto:
Eno Koço



I lashë për në fund harqet, 'dulcis in fundo', mbi tingëllimin e të cilave padyshim mbështetej kjo orkestër.

mentëve, dy solistëve dhe orkestrës, ku që të tre përbënin një ekuilibër muzikor të admirueshëm. Pastërtisë intonative dhe bukurisë së tingullit të flautistes i vishej teknika virtuozë dhe ndjeshmëria e lartë e violinistit dhe që të dy këta nën mbështetjen e baraspeshuar të orkestrës udhëhiqeshin nga stili interpretativ i concerto grosso-s, pleksjes dhe ndërthurjes së kujdesshme të linjave specifike solistike.

Simfonia e Pestë e Çajkovskit në pjesën e dytë të programit zbuloi vlera edhe më të mëdha të kësaj orkestre që ende nuk e ka bërë dekadën e parë të themelimit të saj, për të na dhënë një version kaq

BEFASIA

Sa befasi aq dhe kënaqësi e papërshkrueshme. Disiplinë nga fillimi në fund, që nga paraqitja formale aq e hijshme e muzikantëve në skenë, deri tek disiplina e mirëfilltë e parametrave teknikë muzikorë.

afer traditës së hershme të interpretimit të kësaj simfonie. Interpretimi i natyrës së "stilit rus" dallohej jo aq nga ndërtimi tërësor të strukturës së formës së veprës, se sa në detajet e brendshme e të holla stilistike, gjë që u vu re në solon e famshme e kornos të kohës së dytë ku kornistja e parë tregoi

mjeshtri të vërtetë të teknikës së saj instrumentale duke gërshetuar stilin e hershëm tradicional me një qasje më bashkëkohore. Jo më pak brenda stilit tradicional ishin solot e oboes, klarinetës, fagotit e flautit, po ashtu dhe trombave dhe trombonëve në disa veçori të artikulimit legato të notave e frazimeve të veçanta. Përshtypje mbresëlënëse la ekzekutimi i timpanistit i cili ishte aq brenda stilit e ansamblit sa vështirë se mund ta veçoje nga instrumentet e tjerë frymorë.

I lashë për në fund harqet, 'dulcis in fundo', mbi tingëllimin e të cilëve padyshim mbështetej kjo orkestër. Fakti që dirigjenti i saj vinte nga një përvojë e mirëfilltë solistike dhe si koncert maestër orkestre (i Filarmonisë së Moskës në vitin 1990), kishte bërë që harqet të njihnin një disiplinë nga më të rreptat në fushën e shkollës violinistike botërore. Kontrabasët u shquan më së bukurit në fundin e

Disiplina artistike e parë në skenë dhe e ndjerë nëpërmjet tingëllimit të bën të kuptosh që edhe në këtë vend të vogël mund të kesh një orkestër të vlerave të mëdha.

kohës së dytë, violonçelat në solon aq të njohur po të kësaj kohe, violat dhe violinat në zotërimin teknik të stakatove të kohës së tretë, dhe të gjithë së bashku si sektor për të dhënë një fuzion aq të ndjeshëm në kohën e parë dhe për të shpërthyer "brenda normave" në kohën e katërt, duke përçuar kësaj një shije që linte gjurmë edhe kohë pas mbarimit të koncertit. Koncert-maestri e mbi-zotëronte tërësisht tingëllimin dhe interpretimin e veprave.

I lumtë kësaj orkestre dhe administratorëve që ka në krye që dinë të çmojnë e të udhëheqin muzikantët e saj. Disiplina artistike e parë në skenë dhe e ndjerë nëpërmjet tingëllimit të bën të kuptosh që edhe në këtë vend të vogël të mund të kesh një orkestër të vlerave të mëdha. Salla e re që do të ketë orkestra në shtator të këtij viti, Qendra Kulturore e Malit të Zi, do të rrisë edhe më tej reputacionin e saj (Orkestra pa sallën e saj është si peshku pa ujë). Turnetë që kjo orkestër bën brenda vendit të saj si dhe në vendet fqinjë gjithashtu ndikojnë në të njëjtin drejtim. Fakti që biletat për koncertet e orkestrës janë tërësisht të shitura (sold out) është tregues domethënës pasi kësaj ajo i kthen shtetit një përqindje sado modeste nga ajo që ai harxhon për të. Promocioni që u bëhet veprave kombëtare duke i porositur ato është një tjetër politikë e vlefshme për artin muzikor malazez. Ndjehet në këtë institucion artistik muzikor dora e vëmendjes së shtetit dhe përgjegjësia që ka për të.

* Dirigjent

Nacionalni Simfonijski orkestar Crne Gore je u Teatru Opere i baleta u Tirani 22. marta 2016. godine održao prvi koncert u Albaniji. Otišao sam da slušam orkestar jedne male balkanske države, i našao se pred jednim evropskim orkestrom. Koliko je bilo iznenađujuće i neopisivo zadovoljstvo! Disciplina se vidjela od početka do kraja, počevši od formalnog izgleda muzičara na sceni do suštinske discipline u muzičko-tehničkim parametrima.

Program je bio klasično koncipiran: uvertira, jedna kompozicija crnogorske autorke i koncert za dva solistička instrumenta i orkestar u prvom, a potom simfonija u drugom dijelu koncerta.

Mocartova uvertira za operu „Don Đovani“ dala je ton cijelom koncertu, otkrivajući jedan kompaktan i delikatan zvuk orkestra s jedne strane, dok je s druge pokazala i njegovu sugestivnost, zahvaljujući gromoglasnim i dramatičnim akordima u ovom djelu. Spori početak kompozicije ispoljio je jednu zadivljujuću orkestarsku fuziju, posebno kod gudača, da bi nakon toga uslijedio Mocartov briljantni i vješti stil; svi kontrastirajući elementi koji su u funkciji operске muzičke dramaturgije. Dirigent Grigorij Krasko znao je kako najbolje iskazati zvučnost ovog orkestra, kojeg uglavnom čine mladi muzičari. Prelazi između arhitektonskih fraza uvertire bili su osmišljeni vrlo pažljivo, iako u nekim trenucima i nešto grandioznije.

Kompozitorica Nina Perović se na ovom koncertu predstavila svojim djelom „Gusle“. Moj prijatelj koji je sjedio do mene je rekao da je solo violončelo zazvučalo skoro isto kao naš instrument „lahuta“. Naime, gusle i lahuta su jedno na Balkanu; drugim riječima Crnogorci, a tako i Albanci, vijekovima ovaj instrument upotrebljavaju u svojim tradicijama, i koriste njihove specifične boje i karakteristike za pratnju svojih tradicionalnih pjesama. Sve u svemu, folklorne melodije nastale u planinama imaju mnogo zajedničkih elemenata. Djelo je napisano sa izvanrednim senzibilitetom i u njemu se može osjetiti intelektualna i duhovna snaga, kao i kompozitorkina plodna budućnost.

Koncert za flautu, violinu i orkestar neoklasičnog kompozitora Bohuslava Martinua, interpretirali su solisti orkestra, flautistkinja Marija Đurdjević-Ilić i koncertmajstor Marko Radonić. Elegantna i inteligentna muzika ovog kompozitora se na uspješan način dokazala kroz interakciju tri komponente, dvaju solista i orkestra, koja je rezultirala izvanrednom muzičkom ravnotežom. Intonativna čistoća flautistkinje i njen lijep ton se nadovezao na virtuoзитet i izraženu muzikalnost violiniste, a uz dobro izbalansiranu podršku orkestra, koji je preuzeo interpretativni stil končerta grosa, jednom riječju, sve je bilo kompaktно sastavljeno i pažljivo isprepletano sa specifičnim linijama solista.

„Peta simfonija“ Čajkovskog u drugom djelu koncerta otkrila je još veće vrijednosti ovog orkestra, koji još uvijek nije navršio 10 godina od osnivanja. Njeno tumačenje je bilo toliko blizu staroj tradiciji izvođenja ove simfonije. Interpretacija tipičnog „ruskog stila“ bila je očigledna ne toliko u kompletnoj strukturi djela, koliko kod unutrašnjih, stilističkih detalja koji su se čuli u čuvenoj solo dionici horne u drugom stavu, gdje je (prva) hornistkinja pokazala tehničku

sposobnost i spojila tradicionalni stil sa jednim savremenim pristupom. Isto važi i za solo obou, klarinet, fagot i flautu, takođe trube i trombone u nekim djelovima artikulisanog sviranja legata, a posebno fraziranja. Impresivan utisak ostavilo je i izvođenje timpaniste, koji je toliko bio unutar stila i ansambla da ga je teško bilo izdvojiti od ostalih duvačkih instrumenata.

Ostavio sam za kraj gudače, ‘dulcis in fundo’, na koje se naravno oslanja čitav ovaj orkestar. Činjenica da dirigent ovog orkestra dolazi sa velikim iskustvom soliste i orkestarskog muzičara (koncertmajstor orkestra Boljšog teatra i Moskovske filharmonije), omogućila mu je da u gudačkom korpusu primijeni izvanrednu disciplinu „ruske škole“ koja je, bez sumnje, jedna od najstrožijih violinskih škola na svijetu. Kontrabasi su se istakli posebno na kraju drugog stava, čelisti na čuvenom solu istog stava, viole i violine pri savladavanju tehnike stakata u trećem, i svi zajedno, kao sekcija, ostvarili jako značajnu fuziju, da bi na kraju, predvođeni koncertmajstorom koji je u potpunosti savladao zvučnost i interpretaciju djela, bez pretjerivanja, eksplodirali u četvrtom stavu, uspijevši da ostave snažan utisak koji je trajao i poslije koncerta.

Čestitam ovom orkestru i njegovom menadžmentu koji očigledno zna da cijeni i vodi svoje muzičare. Umjetnički izraz postignut na sceni, koji se osjećao u zvuku, dao nam je do znanja da je i u maloj državi moguće imati orkestar velikih vrijednosti. Nova sala Muzičkog centra Crne Gore, koju će orkestar imati uskoro, podići će još više reputaciju orkestra (orkestar bez svoje sale je kao riba bez vode). Koncerti koje ovaj orkestar realizuje tokom koncertne sezone u Crnoj Gori i gostovanja u susjednim državama imaće snažan uticaj u pravcu daljeg povećanja njegove reputacije. Još jedna vrijedna činjenica za razvoj crnogorske nacionalne muzičke umjetnosti i njenu promociju jeste ulaganje i afirmaciju novih djela, što pokazuje senzibilitet i odgovornost ove institucije (Muzički centar Crne Gore) prema muzici i nacionalnoj kulturi.

*Dirigent Eno Koço